



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P - 74
Prishtinë, më 6 shtator 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR
MË 6 SHTATOR 2012**

Mbledhjen e drejtoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 66 deputetë dhe i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare.

Ai procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Me deklarime jashtë rendit të ditës u paraqitën deputetët: Berat Buzhala, Anton Quni, Rexhep Selimi, Burim Ramadani, Vesna Mikiq, Zenun Pajaziti, Goran Marinković, Hashim Deshishku, Agim Kuleta, Armend Zemaj dhe Liburn Aliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Time Kadrijaj parashtri pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje shkeljet e mundshme ligjore dhe procedurale me rastin e përsëritjes së konkursit për drejtorë të klinikave në QKUK.

Ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje kohën se kur do të ketë furnizim më adekuat në QKUK me barna të listës esenciale nga Ministria e Shëndetësisë.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Rita Hajzeraj-Beqaj.

Deputeti Afrim Kasolli parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se kur dhe si e ka përmendur çështjen e Luginës së Preshevës në bisedimet me Serbinë në Bruksel dhe cili është rezultati?

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm.

Deputeti **Ismet Beqiri**, në emër të GP të LDK-së, propozoi që nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme plenare të hiqet pika - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti**, me arsyetim se teksti i këtij Projektligji nuk ka pësuar ndryshime nga ai i cili ishte në shqyrtim në mbledhjen plenare të sesionit pranveror.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të LDK-së, Ismet Beqiri.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 19,
Abstenime-- ----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti** të hiqet nga rendi i ditës i mbledhjes së sotme.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbalit të seancave të mëparshme,
4. Votimi i Projekt-rezolutës lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës,

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji,
16. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 12-13 korrik 2012, 30-31 gusht 2012 dhe 31 gusht 2012

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 12-13 korrik 2012 dhe 30 gusht 2012.

Deputeti **Hydajet Hyseni** pati vërejtje në procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 31 gusht 2012 lidhur me votimin e Projektligjit për amendamentet e miratuara për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë dhe sidomos për votimin e Projektligjit me amendamentet e miratuara në tërësi. Diskutimi i plotë i deputetit Hydajet Hyseni është dhënë në transkript.

Kryetari sqaroi mënyrën e votimit të amendamenteve në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 31 gusht 2012.

Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi procesverbalin e propozuar.

4. Votimi i Projekt-rezolutës lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, sipas kërkesës së deputetit Agim Kuleta dhe grupit të deputetëve nënshkrues, kanë përfunduar në mbledhjen plenare të datës 30 e 31 gusht 2012. Mirëpo, në mungesë të kuorumit në atë mbledhje nuk ka qenë e mundur të procedohet me votim të tekstit të Projekt-rezolutës.

Kryetari e hodhi në votim Projekt-rezolutën lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, të paraqitur nga deputeti Agim Kuleta, të mbështetur nga deputetët nënshkrues.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 47,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje në nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 6 shtator 2012, miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të marrë vendim për zëvendësimin e kodeve telefonike aktuale që i shfrytëzon Kosova (+381, +386 dhe +377), me kodin telefonik të Republikës së Shqipërisë (+355);
2. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, brenda një kohe shumë të shkurtër t'i iniciojë negociatat me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe
3. Në qoftë se kostoja e shkëputjes së kontratave aktuale valide me ofruesit e kodeve telefonike është më e lartë për vendin sesa respektimi i tyre deri në fund, këto kontrata të zbatohen deri në afatin e paraparë për përfundimin e tyre, por ato të mos vazhdojnë më tutje.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj

Ministri **Bedri Hamza** tha se ky projektligj ka për qëllim ratifikim e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekte ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj.

Në vazhdim, ministri i Financave, Bedri Hamza, u fokusua në kushtet e Marrëveshjes financiare për financimin e ndërtimit të Fabrikës së Ujit në Shkabaj, duke thënë se shuma që do të kërkojë kredimarrësi nuk i tejkalon 20 milionë euro, ndërsa projekti parashihet të realizohet në dy faza. Sa u përket kapaciteteve të kësaj fabrike për prodhimin e ujit, ai tha se ato pas rumbullakimit të tërësishëm të projektit do të jenë 1200 l/s, ndërsa vuri në pah se shfrytëzimi i ujit për këtë fabrikë do të bëhet nga Liqeni i Gazivodës.

Më pas ai theksoi se nga ky projekt përfitojnë rreth 40% e popullatës së Kosovës, ndërsa kapacitetet e projektit në fjalë i vlerësoi të jenë të mjaftueshme për 20-30 vjetët e ardhshme.

Në fund, ministri i Financave, Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari në vazhdim konstatoi se në bazë të nenit 60.3 të Rregullores së Kuvendit, procedimi i projektligjit për ratifikim e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Më pas, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 88,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Miratohet ligji nr.04/L-132 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Ministri i Financave, **Bedri Hamza**, tha se me këtë projektligj ndryshohet ligji nr.03/L-216 për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave, duke marrë parasysh ligjin e ri për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet jobankare, si dhe Direktivën e BE-së për skemat e sigurimit të depozitave, të propozuara nga Komisioni i BE-së, më 2 korrik 2010.

Në vazhdim, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, duke theksuar se ndryshimet konsistojnë në kreun 1, 2 dhe 3 të ligjit ekzistues.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, Hasime Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision Funkcional dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, **Mimoza Kusari-Lila**, tha se ky projektligj i përcakton kushtet, procedurën për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme, ndryshimin, kërkimin e informacionit, si dhe administrimin e regjistrimit të pengut.

Në vazhdim, ajo theksoi se regjistri i pengut lehtëson transaksionet financiare, duke ofruar informata për kreditorët në lidhje me pretendimet ndaj interesave pronësore në sendet e luajtshme, që ka efektin e zvogëlimit të rreziqeve të kreditimit, si dhe rritjes së qasjes së kredi.

Më pas, ministrja u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, ndërsa, në fund, i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hashim Deshishku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Myzejene Selmani - në

emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Amir Ahmeti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision FunkSIONAL dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji.

Ministri **Ramë Buja** tha se me këtë projektligj rregullohen: themelimi, veprimtaria, organizimi, qeverisja dhe suprimimi i personave juridikë, publikë dhe privatë në fushën kërkimore-shkencore, të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve, pozita e Këshillit Kombëtar Shkencor, miratimi dhe zbatimi i Programit Kombëtar Kërkimor-Shkencor, bazat e financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe të inovacionit dhe të teknologjisë.

Në vazhdim, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe në faktorët e involvuar në përpilimin e këtij projektligji, si dhe në debatet publike të mbajtura në lidhje me tekstin e projektligjit.

Në fund, ministri i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë, Ramë Buja, i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Idriz Vehapi - në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Ramë Vataj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lirije Kajtazi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision Funkcional dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për arsimin dhe aftësimin profesional.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë, **Ramë Buja**, tha se ky projektligj ka për qëllim të rregullojë sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në vend, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve drejt ekonomisë së tregut, duke shfrytëzuar në mënyrë optimale burimet financiare, njerëzore dhe të infrastrukturës.

Në vazhdim, ministri tha se projektligji rregullon edhe strukturën, organizimin dhe menaxhimin e institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional.

Në fund, ministri Ramë Buja i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për arsimin dhe aftësimin profesional.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Idriz Vehapi - në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Ramë Vataj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sadri Ferati - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Xhevahire Izmaqi dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në lidhje me procedurën e votimit të këtij projektligji diskutoi deputeti Sabri Hamiti.

Kryetari në vazhdim kërkoi që në përputhje me nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, fillimisht të bëhet votimi vetëm nga deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë, të cilët janë të pranishëm në sallë.

Nga deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë, në sallë ishin të pranishëm shtatë deputetë, dhe që të gjithë këta votuan për miratimin në parim të Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për arsimin dhe aftësimin profesional.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për arsimin dhe aftësimin profesional

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision FunkSIONAL dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Ministri **Mahir Yagcilar** tha se ky Projektligj ka për qëllim t’i përcaktojë organet përgjegjëse për zhvillimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe kompetencat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e tyre.

Në vazhdim, ministri tha se Projektligji e ka një rëndësi të veçantë, ngase është një nga sfidat e raportit të fundit të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën.

Më pas ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e Projektligjit, ndërsa, në fund, i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Idriz Vehapi - në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Xhevahire Izmaqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sadri Ferati - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 70,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision Funkcional dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, për këtë Projektligj nuk e mori fjalën askush.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Idriz Vehapi - në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Xhevahire Izmaqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sadri Ferati - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe deputeti Hydajet Hyseni, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 49,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision Funkcional dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës.

Ministri **Ramë Buja** tha se ky projektligj ka për qëllim ta rregullojë tërësinë e proceseve për arsimimin dhe aftësimin e të rriturve, si pjesë përbërëse e sistemit arsimor në Kosovë

Në vazhdim, ministri u fokusua në çështjet që adreson ky Projektligj, si dhe në strukturën dhe përmbajtjen e tij.

Në fund, ministri Ramë Buja i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Idriz Vehapi - në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Ramë Vataj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lirije Kajtazi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Enis Kervan – në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Vjollca Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi në vazhdim kërkoi që në përputhje me nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, fillimisht të bëhet votimi vetëm nga deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë, të cilët janë të pranishëm në sallë.

Nga deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë, në sallë ishin të pranishëm 10 deputetë dhe 9 nga këta votuan për miratimin e këtij Projektligji.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision Funksional dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e paraqiti deputetja Safete Hadërgjonaj, diskutimi i së cilës është dhënë i plot në transkript.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe amendamentin nr. 8.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 33,
Kundër ----- 27,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e paraqiti deputeti Fikrim Damka, diskutimi i të cilit është dhënë i plot në transkript.

Për këtë pikë të rendit ditës diskutoi edhe deputeti Hydajet Hyseni, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe amendamentin nr. 5.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 52,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji.

Raportin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i të cilit është dhënë i plot në transkript.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe amendamentin nr. 14.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji.

16. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit

Deputeti **Xhevdet Neziraj**, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, tha se si komision ka monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej, ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe para deputetëve i paraqiti rekomandimet nga raporti i Komisionit Funkcional.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hykmete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje, Burim Ramadani - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 03/L- 049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti me rekomandime i Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

* * *

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 16:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale